

Ligjërata 10

BANKA QENDRORE DHE POLITIKA MONETARE

➔ Në këtë kapitull do të njiheni me:

- ➔ *Konceptin e Bankes Qendrore*
- ➔ *Funksionet e Bankes Qendrore*
- ➔ *Objektivat, qëllimet dhe instrumentet e Bankes Qendrore*
- ➔ *Rrymën monetariste dhe veçoritë e saj*
- ➔ *Tregun monetar dhe mekanizmin e politikës monetare*

Hyrje

- Politika monetare është e lidhur ngushtë me Bankën Qendrore (BQ)
- Politika monetare ndikon në
 - GDP,
 - stabilitetin e çmimeve,
 - papunësi etj.
- BQ përmes politikës monetare ka rol kyç në analizën ekonomike të rritjes së GDP-së
- Menaxhimi i politikës monetare bëhet nga BQ përmes instrumenteve që ka në dorë BQ:
 - Operacionet e tregut të hapur
 - Norma e rezervave të detyrueshme
 - Norma bazë e interesit

BANKA QENDRORE: FUNKSIONET DHE INSTRUMENTET

- ➔ Në çdo ekonomi tregu ekzistojnë:
 - ➔ Banka Qendrore (niveli i parë)
 - ➔ Bankat BKomerciale (niveli i dytë)
- ➔ BQ mbikëqyrë politikën monetare
- ➔ Banka Qendrore mbikëqyrë dhe shërben si “ombrellë” për:
 - ➔ Bankat komerciale
 - ➔ Institucionet financiare
 - ➔ Tregun e letrave me vlerë
 - ➔ Kursin e këmbimit

FUNKSIONET E BANKËS QENDRORE

Pesë funksione bazë të BQ:

1. Emetimi i parasë (kartëmonedhave)
 - Plotësimi i nevojave të ekonomisë me para
2. Bankë e bankave të nivelit të dytë:
 - kliringu i çeqeve, rezervat, etj.
 - Mban rezervat e institucioneve
 - Siguron kredi për bankat tjera
3. Bankë e qeverisë (për depozita, tërheqje, etj.)
4. Rregullimi i ofertës monetare
5. Ndërhyrja dhe rregullimi i tregjeve monetare
 - Kontrollon normën e interesit

PAVARËSIA E BANKES QENDRORE

- ➔ Reputacioni i Bankës Qendrore (pritjet e firmave dhe individëve)
- ➔ Banka Qendrore në shumë vende është e pavarur nga qeveria (*qeveria e menaxhon politikën fiskale*)
- ➔ Pavarësia e BQ konsiston në pavarësinë e vendimeve që mund të marrë BQ në lidhje me politikën që do të ndjekë në lidhje me:
 - caktimin e normës së interesit
 - rregullimin e ofertës monetare
 - kreditimin e qeverisë, etj.
- ➔ Por Qeveria ndërhyr në punën e BQ përmes emërimit të drejtuesve të BQ
 - ➔ Drejtuesit e Bankës Qendrore emërohen në periudha afatgjata (*psh. në SHBA guvernatori emërohet për një periudhë 14 vjeçare*)

OBJEKTIVAT, QËLLIMET DHE INSTRUMENTET E BANKËS QENDRORE

- ⇒ Si vepron politika monetare:
 - ⇒ Mekanizmi i transimsionit
- ⇒ Objektivat e politikës monetare
 - Rritje e qëndrueshme ekonomike
 - Stabilitet i çmimeve
 - Punësim i plotë
 - Valutë stabile, etj.
- ⇒ Jo të gjitha objektivat mund të realizohen njëkohësisht
 - ⇒ Lidhja inverse e disa objektivave:
 - ⇒ punësimi i lartë dhe stabiliteti i çmimeve
- ⇒ BQ nuk ka instrument për kontrollimin e realizimit të qëllimeve
 - ⇒ Prandaj përdor objektivat e ndërmjetme:
 - Norma e interesit
 - Oferta monetare

INSTRUMENTET E BANKËS QENDRORE

- ➔ Instrumentet e Politikës Monetare (PM) janë hallka e parë e mekanizmit të transimisionit
- ➔ Instrumentet e PM ndahen në:
 - ➔ **Instrumentet indirekte**
 - ➔ Shitja dhe blerja e letrave me vlerë
 - ➔ bono thesari, obligacione etj.
 - ➔ Ri-financimi:
 - ➔ banka qendrore u jep kredi bankave komerciale
 - ➔ Rezervat e detyrueshme
 - ➔ **Instrumentet direkte**
 - ➔ Nuk kërkojnë treg të zhvilluar financiar (vendet në zhvillim)
 - ➔ Janë të përkohshme pasi ulin konkurrencën në sistemin bankar
 - ➔ Disa nga këto instrumente:
 - ➔ Kontrolli i kreditit: kufizimi i vëllimit të kredisë
 - ➔ Kontrolli i normës së interesit

TREGU MONETAR DHE MEKANIZMI I POLITIKËS MONETARE

- ➔ Tregu Monetar përfshin një bashkësi institucionesh dhe agjentësh ekonomik ku realizohet shitja dhe blerja e letrave me vlerë:
 - Aksionet
 - Obligacionet
 - Bonot e thesarit, etj.
- ➔ **Letrat me vlerë ndahen në:**
 - Afatshkurtra: afati i maturimit < 1 vit
 - Afatgjata: afati i maturimit > 1 vit
- ➔ Bashkëveprimi i ofertës për para dhe i kërkesës për para përcakton sasinë e parasë në qarkullim dhe normën e interesit në ekuilibër

OFERTA DHE KERKESA PËR PARA

➔ Kërkesa për para sipas teorisë Kejnsiane mbështetet në këto motive:

→ **Motivi i transaksioneve**

→ Për të blerë mallra dhe shërbime


→ **Motivi mbrojtës**

→ Për të bërë shpenzime në raste të paparashikuara

→ **Motivi spekulativ**

→ Për të shmangur humbjet që vijnë nga mbajtja e letrave me vlerë

...OFERTA DHE KERKESA PËR PARA



...OFERTA DHE KERKESA PËR PARA

⇒ Kërkesa për para varet nga sasia e kërkuar e parave dhe norma e interesit (figura më lartë):

- Kur rritet i bie kërkesa për para
- Kur rritet GDP rritet kërkesa për para
 - kurba L zhvendoset djathtas
- Oferta për para është e dhënë

Për ilustrim:

Çfarë ndodh në grafik nëse Banka Qendrore dëshiron të ul inflacionin?

- Reduktohet oferta monetare (*kurba MS lëviz majtas dhe rritet i*)
- Njerëzit shesin aktivet e tyre për të plotësuar kërkesën për para
- Kjo shpie në uljen e çmimit të aktiveve dhe rritjen e normës së interesit

...OFERTA DHE KERKESA PËR PARA

➔ *Ndryshimi i ekuilibrit në tregun monetar*

Figura 22.4: Zhvendosja e ofertës monetare





Figura 22.5: Zhvendosja e kërkesës për para



MEKANIZMI I TRANSMISIONIT TË POLITIKËS MONETARE

Politikë monetare ekspansioniste:





Figura 22.6


...MEKANIZMI I TRANSMISIONIT TË POLITIKËS MONETARE

Figura 22.6: Mekanizmi transmisionit të politikës monetare


A. Tregu monetar.



B. Kerkesa per investime



C. Ekuilibri makroekonomik



RRYMA MONETARISE DHE VEÇORITË E SAJ

- Shkolla të ndryshme kanë mendime të ndryshme se si të veprohet me politikën monetare

- **RRYMA MONETARISTE:**
 - Oferta monetare është përcaktues kryesor i lëvizjeve afatshkurtra të GDP-së nominal dhe përcaktues kryesor i çmimeve në periudha afatgjata
 - AD ndikohet vetëm nga oferta monetare
 - Theksohet veprimi i lirë i forcave të tregut - nuk pranohet roli aktiv i shtetit

...RRYMA MONETARISE DHE VEÇORITË E SAJ

- ➔ Në thelb të kësaj teorie është shpejtësia e qarkullimit të parasë (V) në kushtet GDP së dhënë:

$$V = \frac{GDP}{M} = \frac{p_1 \cdot q_1 + p_2 \cdot q_2 + \dots}{M} = \frac{P \cdot Q}{M}$$

V- shpejtësia e parasë;

P- niveli i përgjithshëm i çmimeve;

Q- GDP real

p_1 dhe q_1 - përkatësisht çmimi dhe sasia për të mirën i.

- ➔ Nga ky definim ka lindur teoria sasiore e parasë
- ➔ V është relativisht e qëndrueshme dhe e pandryshueshme
- ➔ Nëse transferohet ekuacioni më lartë, atëherë:

$$P = \frac{MV}{Q} = \left(\frac{V}{Q}\right) \cdot M = kM, \text{ ku } k = \frac{V}{Q}$$

...RRYMA MONETARISTE DHE VEÇORITË E SAJ

- ➔ Konsiderohet se k është relativisht konstant në periudha afatshkurtra
 - V transaksionet janë konstante
 - Q prodhimi potencial nuk ndryshon
- ➔ Duke u nisur nga këto argumente, atëherë lëvizja e çmimeve varet nga ndryshimi në ofertën monetare
- ➔ **Tiparet e rrymës monetariste:**
 - Oferta monetare është përcaktues kryesor i GDP-së nominal dhe i kërkesës agregate (AD) (vetëm paraja ka rëndësi)
 - Çmimet dhe pagat janë fleksibile. Prandaj AS edhe në S-T është vertikale
 - Sektori privat është i qëndrueshëm (tregu funksionon)
 - Oferta monetare duhet të rritet në mënyrë konstante ashtu siç rritet prodhimi i mallrave

Detyrë

- ⇒ **Siguroni të dhëna për depozitat dhe kreditë në Kosovë dhe bëni një vlerësim në lidhje me masën monetare në Kosovë**
 - ⇒ Raporti vjetor 2007 - 2009 i AQBK-së

- ⇒ **Analizoni sjelljen e normës së interesit në Kosovë në periudhën e pasluftës dhe jepni komentet tuaja në lidhje me efektin në investime**

- ⇒ **Duke u nisur nga vlerësimi për GDP në Kosovë dhe pagat mujore, diskutoni sa duhet të jetë V (shpejtësia e qarkullimit të parasë në Kosovës)**